



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



## **DOSJA E TENDERIT**

*Sipas nenit 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085) dhe Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit për*

**“Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit”**

**PROCEDURA ME OFERTË TË HAPUR**

Data e publikimit të Dosjes së Tenderit:

13.10.2021

**Titulli: Zgjedhja e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit**

**KJO DOSJE E TENDERIT PËRBËHET NGA DY PJESË:**

**Pjesa A: Procedurat e tenderimit që përmbajnë instruksione se si të përgatiten tenderët;**

**Pjesa B: Forma e tenderit, d.m.th. dokumentet që duhet të dorëzohen nga tenderuesit.**

**Kjo dosje e tenderit është përgatitur në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.**



## LËNDA: FTESA PËR TENDER për Zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit

Ju faleminderit për interesimin tuaj për pjesëmarrje në aktivitetin e lartpërmendur.

Në përgjigje të kërkesës suaj, ju lutem gjeni të bashkangjitura dokumentet, që përbëjnë Dosjen e Tenderit.

Nga ju pritet të shqyrtoni me kujdes të gjitha pjesët dhe seksionet e kësaj dosjeje tenderi dhe shtojcave të saj për të qenë në pajtim me të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përfshira këtu.

ZRRE nuk do të pranojë asnjë përjashtim nga kushtet dhe specifikat e përfshira në këtë dosje tenderi.

Nëse dështoni të dorëzoni një tender në ZRRE brenda afatit të specifikuar në këtë dosje tenderi dhe/apo që nuk është në përputhje me të gjitha kërkesat e vendosura në këtë dosje, i njëjti do të refuzohet dhe do të konsiderohet si *"tender i papërgjegjshëm"*.

Shpenzimet për përgatitjen dhe dorëzimin e tenderit nuk do të rimbursohen dhe asnjë borxh i juaji nuk do të merret parasysh nga ZRRE në rast të anulimit të procedurës.

Procedura e këtij tenderi rregullohet në pajtim me nenin 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085.

Rregulla e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit mund të shkarkohet nga uebfaqja e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE): [www.ero-ks.org](http://www.ero-ks.org).

Tenderët duhet të dorëzohen në adresën e specifikuar në pjesën A "Procedurat e Tenderimit", deri me datën **12.11.2021**, ora 14:00.

Me dorëzimin e një tenderi, tenderuesi pranon në tërësi dhe pa asnjë kufizim kushtet e paraqitura në këtë Dosje të Tenderit, që rregullojnë këtë shërbim të propozuar si baza e vetme e kësaj procedure të tenderimit.

Ne presim të pranojmë tenderin tuaj,

Nëse ju vendosni të mos dorëzoni tender, do të ishim mirënjohës nëse do të na informoni me shkrim, duke deklaruar arsyet për vendimin e juaj.

I juaji sinqerisht,

Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së

DOSJA E TENDERIT – ZGJEDHJA E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT



## TABELA E PËRMBAJTJES

PJESA A: PROCEDURAT E TENDERIMIT .....	4
SEKSIONI I. INFORMATAT PËR TENDERUESIT .....	4
TË PËRGJITHSHME .....	4
KUSHTET QË DUHET PLOTËSUAR NGA TË LICENCUARIT PËR FURNIZIM .....	5
PËRMBAJTJA E DOSJES SË TENDERIT .....	8
PËRGATITJA E TENDERËVE .....	9
DORËZIMI DHE HAPJA E TENDERËVE .....	10
VLERËSIMI DHE KRAHASIMI I TENDERËVE .....	12
DHËNIA E KONTRATËS .....	12
SEKSIONI II. ANEKSET INFORMATIVE PËR TENDERUESIT .....	13
ANEKSI 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE OBLIGATIVE .....	13
ANEKSI 2. DEKLARATA NËN BETIM .....	14
ANEKSI 3. KËRKESA PËR KONFIDENCIALITET .....	15
ANEKSI 4. KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË .....	16
ANEKSI 5. KRITERI PËR DHËNIE .....	17
ANEKSI 6. MODELI I GARANCIONIT PËR PERFORMANCË .....	18
PJESA B: FORMULARI I DORËZIMIT TË TENDERIT ERROR! DEFINED.	BOOKMARK NOT
SEKSIONI I. FORMULARI I TENDERIT .....	19
SEKSIONI II. OFERTA FINANCIARE .....	21



## **PJESA A:           PROCEDURAT E TENDERIMIT**

### **Seksioni I. Informatat për tenderuesit**

#### **Të përgjithshme**

- 1. Shtrirja e tenderit**
- 1.1 ZRRE, siç shënohet në Vendimin për hapjen e procedurës së ofertimit për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit (V\_1417\_2021), lëshon këtë dosje tenderi për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.
- 1.2 Titulli i këtij aktiviteti është "Zgjedhja e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit" për të ofruar shërbime të Furnizimit të Garantuar me energji elektrike.
- 1.3 Tenderët duhet të dorëzohen në adresën e ZRRE-së: Rr. Dervish Rozhaja, nr. 12, 10000, Prishtinë, Kosovë.
- 1.4 Kur shërbimet të jenë dhënë, të gjitha dispozitat relevante në lidhje me shërbimet e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit do të aplikohen dhe Licenca e Furnizimit e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit të zgjedhur do të plotësohet nga ZRRE në përputhje me rrethanat.
- 1.5 Bazuar në diskrecion të arsyeshëm, ZRRE mund të anulojë procesin tenderues ose të ndërpresë dhënien dhe zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.
- 1.6 Përgjatë kësaj Dosje Tenderi:
- (a) termi "me shkrim" nënkupton i komunikuar në formë të shkruar (p.sh. me postë, email, faks) me dëshmi të pranimit;
  - (b) nëse e kërkon konteksti, "njëjës" po ashtu nënkupton "shumës" dhe anasjelltas;
  - (c) "ditë" nënkupton një ditë kalendarike;
  - (d) juve ju referohemi si "i licencuari për furnizim" ose "tenderuesi"; dhe
  - (e) lëshuesi i kësaj dosje tenderi referohet si "ZRRE".
- 2. Synimi i tenderit**
- 2.1 Synimi i këtij tenderi është që të zgjedhë Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 40 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085), për të ofruar shërbimet e Furnizimit të Garantuar me energji elektrike, sipas rrethanave të përcaktuara sipas nenit 39 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L-085).
- 3. Specifikimet teknike të detyrueshme**
- 3.1 Shërbimi duhet të jetë plotësisht në përputhje me specifikimet teknike të vendosura në këtë Dosje Tenderi, Aneksi 1.
- 3.2 Çfarëdo specifikimi tjetër i ofruar, që nuk është në përputhje me specifiket teknike të dosjes së tenderit do ta diskualifikojë tenderin.



#### 4. Variantet

4.1 Përderisa nuk shënohet ndryshe, tenderuesit nuk autorizohen të dorëzojnë një tender që propozon një variant tjetër nga ai që ofrohet tek specifikimet teknike.

#### 5. Kërkesat dhe kushtet e zbatimit

5.1 Vendi i performancës së shërbimeve është territori i Republikës së Kosovës.

5.2 Kohëzgjatja e shërbimeve është për një periudhë prej 3 viteve nga data e zgjedhjes, gjegjësisht Vendimit të ZRRE për caktimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

### KUSHTET që duhet plotësuar nga të licencuarit për furnizim

Të licencuarit për furnizim duhet të pajtohen me kërkesat si në vijim. Çfarëdo dështimi për cilindo kusht do të eliminojë tenderët e tyre nga konkurrenca.

#### Kushtet e kualifikimit

#### 6. Kualifikimi i Tenderuesve

6.1 Vetëm Furnizuesit e licencuar nga ZRRE janë të kualifikuar për pjesëmarrje në procedurën e tenderit me ofertim të hapur për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

6.2 Një i licencuar për furnizim nuk do kualifikohet për pjesëmarrje në aktivitetin e procedurës me ofertim të hapur nëse një i licencuar për furnizim, ose ndonjë i punësuar, drejtues, menaxher ose drejtor i saj:

- a. ka marrë pjesë në përgatitjen e dosjes së tenderit, ose çfarëdo pjesë të saj, që përdoret nga ZRRE;
- b. ka pranuar ndihmë në përgatitjen e tenderit të saj ose kërkesa për të marrë pjesë nga një person ose ndërmarrje që ka marrë pjesë në përgatitjen e dosjes së tenderit, ose çfarëdo pjesë të saj; ose
- c. në çfarëdo rasti ka qenë në konflikt interesi.

6.3 Një i licencuar për furnizim nuk do të kualifikohet për pjesëmarrje në një aktivitet me procedurë të ofertimit të hapur nëse një i licencuar i tillë, ose çfarëdo drejtuesi, menaxheri ose drejtori i saj, në **dhitë (10) vitet e fundit:**

- a. është vendosur nga një gjykatë e juridiksionit përkatës se ka kryer një vepër penale që përfshin praktika të korruptuara, shpëlarje të parave, ryshfet, haraç ose aktivitete të përshkruara, ose të ngjashme me ato të përshkruara, sipas ligjeve apo rregulloreve të aplikuara në Kosovë ose në një vend tjetër, ose sipas traktateve dhe konventave ndërkombëtare;
- b. janë deklaruar të pakualifikuar, ku ZRRE gjen se kjo përbën një sjellje të rëndë joprofesionale, të verifikuar nga një gjykatë përkatëse;



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



- c. është vendosur nga një gjykatë e juridiksionit përkatës se ka kryer shtrembërim të fakteve ndaj një autoriteti publik në Kosovë apo diku tjetër.

**6.4 Një i licencuar për furnizim nuk do të kualifikohet për pjesëmarrje në një aktivitet të procedurës së tenderit me ofertim të hapur nëse:**

- a. në dy (2) vitet e kaluara, është deklaruar i bankrotuar ose i falimentuar nga një gjykatë e juridiksionit përkatës, ose aktualisht është në seanca: (i) për deklarim të bankrotimit, (ii) për urdhër për likuidim të detyrueshëm nga administrata ose gjykata ose iii) çfarëdo seancash të tjera sipas ligjit të Kosovës ose çfarëdo juridiksioni tjetër;
- b. është duke u likuiduar ose administruar, ose punët e saj janë duke u likuiduar ose administruar, nga një gjykatë e juridiksionit përkatës;
- c. aktualisht ka një marrëveshje ose aranzhim me kreditorët e saj që sigurojnë afate shtesë ose të reduktuara të pagesës nëse këto afate janë pajtuar nga këta kreditorë për shkak se i licencuari për furnizim nuk ka qenë në gjendje të përmbush detyrimet e tij në afat;
- d. është në një situatë të ngjashme me nënparagrafët a, b apo c të këtij paragrafi që del nga procedura e ngjashme me ligjet në vendin e themelimit të saj ose të një vendi ku ajo bën biznes;
- e. aktualisht i nënshtrohet një urdhëri gjyqësor ose administrativ që ia suspendon ose redukton pagesat ndaj dhe nga një i licencuar për furnizim dhe që rezultojnë me humbje të pjesshme të së drejtës së të licencuarit për furnizim për të administruar dhe/apo sistemuar pronën e tij;
- f. aktualisht është në seanca ligjore ose administrative që mund të rezultojnë me një urdhër gjyqësor ose administrativ që ia suspendon ose redukton pagesat ndaj dhe nga një i licencuar për furnizim nëse këto seanca mund të rezultojnë me vendim që i licencuari për furnizim të deklarohet i bankrotuar ose i falimentuar;
- g. në tri (3) vitet e fundit, është deklaruar nga një gjykatë e juridiksionit përkatës se ka shkelur në mënyrë serioze një kontratë me një entitet publik, autoritet publik ose ndërmarrje publike në Kosovë ose tjetërkund;
- h. aktualisht nuk është duke paguar kontributet për siguri sociale ose taksat në Kosovë ose në vendin e themelimit të të licencuarit për furnizim, përveç kur një borxh i tillë vlerësohet si i parëndësishëm në Kosovë;
- i. ka më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë që nuk ka kryer pagesën e çfarëdo page që ua ka borxh punëtorëve ose pagesën e çfarëdo shume që ia ka borxh një operatori të shërbimeve publike në Kosovë;
- j. nuk ka vepruar në përputhje me një vendim të lëshuar nga një gjykatë e Kosovës, ose



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



- k. ka bërë deklaratime të rreme në raport me procedurën për dhënien e kontratës publike, nëse ato ndërlidhen me mungesën e arsyeve për diskualifikim, ose përmbushjen e kriterëve të përzgjedhjes.

***Limitet kohore të vendosura në këtë seksion, janë të ndërlidhura me periudhën që i paraprin datës së publikimit të Vendimit për hapjen e procedurës së ofertimit për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.***

6.5 Në mënyrë që të dëshmohet se i licencuari për furnizim kualifikohet për të marrë pjesë në aktivitetin e procedurës së ofertimit të hapur, i licencuari për furnizim duhet të dorëzojë dëshmitë me dokumente të kërkuara në këtë dosje tenderi.

**7. Kushtet për përshtatshmëri profesionale, teknike dhe financiare**

I licencuari për furnizim duhet të plotësojë kushtet për përshtatshmëri profesionale, teknike dhe financiare, si në nenin 4 të Rregullës për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit.

**8. Informatat konfidenciale të biznesit**

Nëse i licencuari për furnizim dëshiron që çfarëdo informate e ofruar sa i përket qëndrueshmërisë financiare dhe aftësive teknike/profesionale të trajtohet si informatë konfidenciale e biznesit, duhet të dorëzohet një kërkesë me shkrim duke shfrytëzuar formën e vendosur në këtë dosje tenderi, shih **Aneksin 3**.

**9. Themelimi i një grupi të të licencuarve për furnizim**

Dorëzimi i tenderit nga një grup i të licencuarve për furnizim, **nuk lejohet**.

**10. Nënkontraktimi**

I licencuari për furnizim **nuk lejohet të nënkontrakttojë shërbimet e dhëna me këtë tender**.

**11. Siguria e performancës**

11.1 Para zgjedhjes si Furnizues i Mundësisë së Fundit, tenderuesi i suksesshëm, duhet të dorëzojë në ZRRE një sigurim të performancës, në formën e paraqitur në **Aneksin 6**.

11.2 Sigurimi i performancës duhet të jetë në shumën dhe periudhën e validitetit të përcaktuar në **Aneksin 6**.

11.3 Forma e sigurimit të performancës është specifikuar në pjesën B, shih **Aneksin 6**.

11.4 Sigurimi i performancës mund të postohet në një nga format e shënuara për sigurimin e tenderit.

11.5 Dështimi i të licencuarit të suksesshëm për furnizim për të dorëzuar sigurimin e performancës së përmendur më lart përbën bazë të mjaftueshme për anulimin e kontratës dhe konfiskimin e sigurimit të tenderit.

11.6 Sigurimi i performancës do të konfiskohet në rastet kur:



- a) janë shkelur kushtet e dhëna nga ZRRE pas zgjedhjes dhe
- b) janë shkelur detyrimet e pranuar dhe shumë punëtorë dhe/apo furnizues të materialeve kanë mbetur të papaguar;

11.7 Nëse asnjëra nga të cekurat më lart nuk kanë ndodhur, e që kushtëzojnë konfiskimin e sigurimit të performancës, ZRRE do t'i kthejë fondet ose dokumentet që përbëjnë këtë sigurim performance në pajtim me kushtet e kontratës në fjalë.

### **Përmbajtja e dosjes së tenderit**

#### **12. Seksionet e dosjes së tenderit**

12.1 Dosja e tenderit konsiston në pjesët A dhe B, e cila përfshin të gjithë seksionet e shënuar më poshtë, dhe duhet të lexohet në ndërlidhje me çfarëdo shtojce që lëshohet në pajtim me informatat për tenderuesit, seksioni II.

#### **PJESA A Procedurat tenderuese**

- Seksioni I. Informatat për tenderuesit
- Seksioni II. Aneksat me informata për tenderuesit

#### **PJESA B Forma e tenderit**

- Seksioni I. Formulari i tenderit
- Seksioni II. Përshkrimi i Ofertës Financiare

#### **13. Qartësimi i Dosjes së Tenderit**

13.1 Tenderuesve u lejohet të bëjnë kërkesë me shkrim në ZRRE për informata shtesë ose qartësuese që ata besojnë se u nevojiten për të përgatitur ose dorëzuar një tender të përgjegjshëm. Kjo kërkesë e tillë mund të bëhet duke shfrytëzuar formën e kërkesës, shih **Aneksin 4**, dhe duke e dorëzuar në ZRRE në formë elektronike, me letër ose me faks. ZRRE do të përgjigjet me shkrim ndaj çfarëdo kërkesë për qartësim, nëse kjo kërkesë pranohet jo më vonë se 15 ditë kalendarike nga data e publikimit të dosjes së tenderit. ZRRE duhet t'iu dërgojë kopjet e përgjigjes së saj tek të gjithë ata që kanë pranuar dosjen e tenderit, duke përfshirë një përshkrim të pyetjes, por pa identifikuar burimin e saj. Nëse ZRRE e sheh të nevojshme për të plotësuar dosjen e tenderit si rezultat i një qartësimi, ajo do ta bëjë këtë duke ndjekur procedurën sipas informatave për tenderuesit, seksioni I.

#### **14. Plotësim-ndryshimi i Dosjes së Tenderit**

14.1 Në çfarëdo kohe para afatit të dorëzimit të tenderëve, ZRRE mund ta plotësojë apo ndryshojë Dosjen e Tenderit duke lëshuar një shtesë.

14.2 Çdo shtesë e lëshuar do të bëhet pjesë e Dosjes së Tenderit dhe do t'u komunikohet me shkrim të gjithë të licencuarve për furnizim që kanë marrë Dosjen e Tenderit.

14.3 Për t'u dhënë tenderuesve të mundshëm kohë të arsyeshme për ta marrë parasysh shtojcën gjatë përgatitjes së tenderëve të tyre, ZRRE duhet të shtyjë afatin për dorëzimin e tenderëve, që nuk duhet të jetë më pak se 10 ditë kalendarike.





## Përgatitja e TENDERËVE

### 15. Gjuha e tenderëve

Të licencuarit për furnizim duhet të përgatisin dhe dorëzojnë tenderin e tyre dhe dokumentet e ndërlidhura në gjuhën shqipe apo serbe.

### 16. Dokumentet që përfshihen në tender

Tenderi do të përfshijë si në vijim:

- a) Formën e tenderit dhe përshkrimin e çmimit të aplikueshëm duke shfrytëzuar format e vendosura në pjesën B të kësaj dosje tenderi;
- b) Sigurimin e tenderit, në pajtim me informatat për tenderuesit, seksioni 13, *nëse aplikohet*;
- c) Evidenca me dokumente në pajtim me informatat për tenderuesit, seksioni 6 që dëshmon kualifikimin e tenderuesit;
- d) Evidenca me dokumente në pajtim me informatat për tenderuesit, seksioni 7 që dëshmon përshtatshmërinë profesionale të tenderuesit, *nëse aplikohet*;
- e) Evidenca me dokumente në pajtim me informatat për tenderuesit, seksioni 8 që dëshmon qëndrueshmërinë ekonomike dhe financiare të tenderuesit, *nëse aplikohet*;
- f) Evidenca me dokumente në pajtim me informatat për tenderuesit, seksioni 9 që dëshmon aftësitë teknike dhe profesionale të tenderuesit, *nëse aplikohet*;
- g) Evidenca me dokumente në pajtim me informatat për tenderuesit, seksionet 11 dhe 12, *nëse aplikohet*; dhe

### 17. Valuta dhe llogaritja e çmimit

17.1 Të gjitha çmimet e specifikuar në tenderë duhet të deklarohen në Euro (€), duke përfshirë Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH). Oferta Financiare e ofruar lejohet të shënohet maksimum me dy (2) numra decimalë pas pikës decimale. Çfarëdo numri i listuar pas numrit të dytë (2) nuk do të merret parasysh në llogaritjen e vlerës së ofertës.

17.2 Oferta Financiare për shërbimet e ofruara është e fiksuar gjatë performancës 3 vjeçare të tenderuesit dhe nuk i nënshtrohet rishikimit.

17.3 Oferta Financiare, për qëllim të kësaj Dosje të Tenderit, nënkupton Koston Direkte të Furnizimit me Pakicë të parashikuar kumulative siç përcaktohet në Rregullin për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit, për periudhën e dhënë për performancë 3 vjeçare.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**18. Periudha e validitetit të tenderit**

18.1 Tenderët do të mbeten validë për një periudhë prej 60 ditësh ose çfarëdo date tjetër të përcaktuar me Vendimin për hapjen e procedurës së ofertimit për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit. Periudha e validitetit të tenderit do të fillojë në datën e afatit për dorëzimin e tenderëve. Një tender valid i ofruar për një periudhë më të shkurtër do të refuzohet nga ZRRE si i papërgjegjshëm. 18.2 Në rrethana të jashtëzakonshme, para skadimit të periudhës së validitetit të tenderit, ZRRE mund t'u kërkojë tenderuesve të shtyjnë periudhën e validitetit të tenderëve të tyre. Kërkesa dhe përgjigjet duhet të jenë me shkrim. Nëse kërkohet sigurimi i tenderit, i njëjti po ashtu duhet të shtyhet për periudhën korresponduese. Dështimi për t'u përgjigjur kërkesës së bërë nga ZRRE do të rezultojë me refuzimin e tenderit pa e konfiskuar sigurimin e tenderit.

**19. Mbyllja dhe vulosja e tenderëve**

19.1 Tenderuesi duhet të përgatisë një kopje origjinale të dokumenteve që përbëjnë tenderin, siç përshkruhet në informatat për tenderuesit, seksioni 19, dhe në mënyrë të qartë të shënojë atë "**ORIGJINAL.**" Përveç kësaj, tenderuesi duhet të dorëzojë 3 (tri) kopje të tenderit, në numrin e shënuar në FDT dhe në mënyrë të qartë t'i shënojë ato si "**KOPJE.**"

19.2 Tenderuesi duhet të mbyllë tenderin original dhe secilën kopje **në zarfe të ndara** dhe, në secilën ballinë të këtyre zarfeve:

- Të shënojë qartazi "**Original**" ose "**Kopje**";
- Siç deklarohet në dosjen e tenderit; dhe
- Shënojë emrin dhe adresën e tenderuesit.

19.3 Zarfet duhet që të mbyllen në një zarf tjetër të shënuar me:

- Adresën e vendit për dorëzimin e tenderëve;
- Titullin e tenderit sikurse është publikuar në këtë dosje tenderi;
- Vërejtjen që zarfi nuk duhet të hapet para datës dhe kohës së hapjes së tenderit; dhe
- Emrin dhe adresën e tenderuesit.

**Dorëzimi dhe hapja e tenderëve**

**20. Afati për dorëzimin e tenderëve**

Tenderët do të dorëzohen në ZRRE në adresën (Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë) deri me datë **12.11.2021, ora 14:00.**

**21 Tenderët e vonuar**

ZRRE nuk do të marrë parasysh asnjë tender që arrin pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve. Çdo tender i pranuar pas afatit për dorëzimin e tenderëve do të deklarohet i vonuar, do të refuzohet dhe do të kthehet i pahapur te tenderuesi.

**22. Tërheqja, Zëvendësimi, dhe**

22.1 Përveç nëse definohet ndryshe, Tenderuesi mund të tërheqë, të zëvendësojë apo të modifikojë tenderin e tij pasi të jetë dorëzuar përmes dërgimit të njoftimit me shkrim në ZRRE, e nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar.



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**Modifikimi i  
Tenderëve**

Zëvendësimi apo modifikimi përkatës i tenderit duhet të shoqërohet me njoftim të shkruar. Të gjitha njoftimet duhet të:

- (a) dorëzohen në përputhje me Informacionin për Tenderuesit, Seksioni I dhe përveç kësaj, në zarfet përkatës, do të shënohet qartë "TËRHEQJE," "ZËVENDËSIM" ose "MODIFIKIM"; dhe
- (b) pranohet nga ana e ZRRE-së përpara afatit të paraparë për dorëzimin e tenderëve.

22.2 Tenderët e kërkuar për t'u tërhequr, do të kthehen të pahapura tek Tenderuesit.

22.3 Asnjë tender nuk mund të tërhiqet në intervalin ndërmjet afatit të fundit për paraqitjen e ofertave dhe skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit. Tërheqja e tenderit gjatë këtij intervali do të rezultojë në konfiskimin e sigurisë së tenderit.

**23. Hapja e tenderit**

23.1 ZRRE do të bëjë hapjen publike të tenderit në adresën, Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, Prishtinë, Kosovë, me datë **15.11.2021, në ora 14:00**

23.2 Çdo tenderues ka të drejtë të ketë një përfaqësues që të vëzhgojë hapjen e tenderëve.

23.3 Nëse tërheqjet, zëvendësimet apo modifikimet janë të lejuara, së pari zarfet të shënuara "TËRHEQJE" duhet të hapen dhe lexohen dhe zarfi me tender përkatës nuk do të hapet, por do të kthehet tek Tenderuesi. Nëse zarfi për tërheqje nuk përmbanë kopjen e "autorizimit ligjor" që konfirmon nënshkrimin si person i autorizuar zyrtarisht për të nënshkruar në emër të tenderuesit, atëherë tenderi përkatës do të hapet. Tutje, zarfet e shënuara me "ZËVENDËSIM" do të hapen dhe do të lexohen dhe do të shkëmbehen me tenderin përkatës zëvendësues dhe tenderi i zëvendësuar nuk do të hapet, por do t'i kthehet tenderuesit. Zarfet e shënuara me "MODIFIKIM" do të hapen dhe lexohen me Tenderin përkatës.

23.4 Tërheqja e tenderit, zëvendësimi apo modifikimi do të lejohet vetëm nëse njoftimi përkatës për tërheqje, zëvendësim apo modifikim, përmban një autorizim valid për të kërkuar tërheqjen, zëvendësimin apo modifikimin dhe i njëjti lexohet në hapjen e Tenderit. Vetëm zarfet që janë hapur dhe lexuar në hapjen publike të tenderëve do të konsiderohen më tutje.

23.5 Të gjitha zarfet e tjera do të hapen në një kohë, duke lexuar: emrin dhe adresën e tenderuesit, çmimin e përgjithshëm të tenderit të specifikuar në formularin e dorëzimit të Tenderit dhe sa herë që të jetë e mundur, çmimet për njësi. Kur, për arsye jo të menjëhershme, çmimet për njësi nuk mund të lexohen, atëherë çmimet e tilla në çdo rast do të jenë të dukshme për të gjithë përfaqësuesit e ofertuesve, pjesëmarrës në hapjen publike, psh postimi i tyre ose duke përdorur ndonjë metodë tjetër të përshtatshme që garanton transparencën. Në çdo rast, çdo faqe e ndonjë tenderi financiar duhet të nënshkruhet gjatë hapjes publike nga një përfaqësues i një tjetër tenderuesi, si dhe çdo gjë që ka të bëjë me shifrat duhet të lexohet me zë të lartë, të tilla si koha e dorëzimit, periudha e garancisë etj. E gjithë kjo duhet të regjistrohet në procesverbalin e hapjes së tenderëve, i cili duhet të



nënshkruhet nga Zyrtari i Prokurimit dhe nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin e hapjes së tenderëve. Kopjet e procesverbalit në fjalë menjëherë do të shpërndahen për të gjithë tenderuesit.

### **Vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve**

#### **24. Shqyrtimi i tenderëve**

24.1 Tenderët e pranuar me kohë do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen sipas kërkesave të parashtruara në këtë dosje të tenderit.

24.2 Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur të:

- a. përputhet nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit, dhe
- b. përputhet me kërkesat e përcaktuara me Rregullën për Furnizuesin e mundësisë së fundit.

#### **25. Sqarimi i tenderëve**

25.1 Për të ndihmuar në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, ZRRE mundet që, në diskrecionin e saj, të kërkojë nga cilido tenderues ndonjë sqarim rreth tenderit të tij. ZRRE mund të ftojë tenderuesit për të plotësuar apo qartësuar çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura. Megjithatë, sigurimi i informacioneve që mungojnë ose dhënia e informacionit do të aplikohet vetëm për dokumente ekzistencë e të cilave është caktuar para skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe mund të verifikohen në mënyrë objektive. Çdo sqarim i dorëzuar nga tenderuesi në lidhje me tenderin e tij dhe që nuk është përgjigje ndaj kërkesës së ZRRE-së, nuk do të merret parasysh.

25.2 Kërkesat për sqarime dhe përgjigjet duhet të bëhen vetëm me shkrim, por nuk mund të kërkohet, ofrohet ose lejohet asnjë ndryshim në çmim.

#### **26. Përgjegjshmëria e tenderëve**

26.1 Nëse tenderi nuk është i përgjegjshëm do të refuzohet dhe nuk mund të bëhet më vonë i përgjegjshëm duke e korigjuar atë ose duke e tërhequr largimin ose kufizimin.

26.2 Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen dhe krahasohen sipas kriterëve të dhënies, të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Dhënia e kontratës do të bëhet për tenderuesin e ranguar më së larti.

### **Dhënia e kontratës**

#### **27. Kriteret e dhënies**

Shërbimet do të jepen sipas kriterëve për dhënie të kontratës, të paraqitura në Aneksin 5.



## **Seksioni II. Anekset informative për Tenderuesit**

### **Aneksi 1. SPECIFIKIMET TEKNIKE OBLIGATIVE**

- 1..... Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë i obliguar të ofrojë të gjitha shërbimet e furnizuesit siç përcaktohet me Ligjin mbi Energjinë Elektrike, me Rregullën e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe në licencën përkatëse të lëshuar nga ZRRE duke përfshirë, por që nuk është e kufizuar:
  - 1.1.... Prokurimin e energjisë elektrike me shumicë në emër të klientëve të furnizuar sipas shërbimeve të furnizimit të garantuar dhe të jetë përgjegjës për balancimin e marrjes së tyre me furnizim të tillë me shumicë;
  - 1.2.... Furnizimin dhe faturimin e konsumatorëve për periudhën e përcaktuar të furnizimit;
  - 1.3.... Informimin e konsumatorëve të lidhur me këtë shërbim me kushtet e shërbimit të ofruar; dhe
  - 1.4.... Dorëzimin e kontratave të furnizimit për konsumatorët që furnizohen.
- 2..... Furnizuesi i mundësisë së fundit është i obliguar që:
  - 1.5.... Të dorëzojë kontratat për konsumatorët përkatës brenda tetë (8) ditësh nga fillimi i furnizimit dhe jo domosdoshmërisht të paraqesë këto kontrata para fillimit;
  - 1.6.... Të informojë konsumatorët e kualifikuar për Shërbimin Universal mbi mjetet e kontratës me cilindo furnizues me obligim për Shërbimin e Furnizimit Universal (pavarësisht nëse një furnizues i tillë e ka atë obligim përmes Obligimit të Shërbimit Publik apo të ndonjë mënyre tjetër), duke përfshirë atë nëse Furnizuesi i Mundësisë së Fundit ka edhe Obligim të Furnizimit Universal.
  - 1.7.... Të mirëmbajë një uebfaqe dhe të publikojë informata për konsumatorët rreth shërbimeve të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit duke përfshirë informatat rreth numrit të konsumatorëve të furnizuar nën shërbimin e Mundësisë së Fundit, ndaras për konsumatorët e amvisërisë dhe jo-amvisërisë, kohëzgjatjen mesatare të shërbimeve të tilla duke përfshirë detajet ndaras për konsumatorët të cilët janë të kualifikuar për Shërbimin e Furnizimit Universal dhe për ata të cilët nuk janë të kualifikuar; dhe
  - 1.8.... Të publikojë në uebfaqen e vet çmimet të cilat do t'i faturojë nën Shërbimin e Furnizuesit të mundësisë së Fundit.
- 3..... Furnizuesi i Mundësisë së Fundit duhet të mbajë llogari të ndara në lidhje me raportet e tij me konsumatorët e furnizuar nën Shërbimin e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit dhe t'i vejë këto llogari në dispozicion të ZRRE-së për inspektim, kur kjo të kërkohet.
- 4..... Furnizuesi i Mundësisë së Fundit duhet të krijojë lehtësira për konsumatorët që të gjejnë furnizuesin alternativ brenda 60 ditësh por duhet të ngrisin procedura për të ndërprerë furnizimin për konsumatorët të cilët nuk kontraktajnë me furnizues alternativ.
- 5..... Furnizuesi i Mundësisë së Fundit duhet të mbajë mbulesë kreditore për të siguruar se është në gjendje të ofrojë shërbimin në momentin që kërkohet prej tij ta bëjë një gjë të tillë.
6. Furnizuesi i Mundësisë së Fundit duhet të jetë në pozitë të ofrojë një shërbim të arsyeshëm dhe konkurrues të furnizimit për konsumatorët e tij në periudhën e Furnizimit të Garantuar.



## Aneksi 2. DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [të licencuarin për furnizim] deklaroj nën betim se jam i kualifikuar në pajtim me Nenin 40 të Ligjit mbi Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085) dhe Rregullën për Furnizuesin e Mundësisë së Fundit.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë të publikuar në këtë dosje të tenderit dhe në Vendimin për hapjen e procedurës së tenderimit për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit, dhe i përmbushi kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë proces të tenderit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë me dashje ose nga pakujdesia paraqes çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësisht të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i të licencuarit për furnizim	
Emri i Furnizuesit:	
Adresa e plotë:	
Përfaqësuar nga:	
Emri	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data	
Vula	



### Aneksi 3. KËRKESA PËR KONFIDENCIALITET

Për: Zyrën e Rregullatorit për Energji, Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë (Tutje "ZRRE")

DUKE PASUR PARASYSH SE [emri i të licencuarit të furnizimit] (më tej "Licencuari i Furnizimit"), duke përbushur kërkesat e dosjes së tenderit nën aktivitetin e cekur më lartë të tenderit të hapur, Pjesa 8 dhe 9 e Informatave për tenderuesit, ka ofruar informatat afariste konfidenciale si në vijim:

*Identifikimi i informacioneve konfidenciale dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:*

DHE DUKE PASUR PARASYSH informacionet e përmendura kësajsoj janë deklaruar që (i) të mos jenë në domenin publik, dhe (ii) për t'u mbrojtur nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e të Licencuarit për Furnizim;

DHE DUKE PASUR PARASYSH se qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të të licencuarit për Furnizim nga arsyet e mëposhtme:

*Deklarata për natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyet pse do të ndodhë:*

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar të Licencuarin për Furnizim nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që ZRRE t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e cekura si informacione konfidenciale afariste.

Identifikimi i të licencuarit për furnizim	
Emri i Kompanisë	
Adresa e plotë	
Përfaqësuar nga:	
Emri	
Pozita	
Nënshkrimi	
Data	
Vula	



## Aneksi 4. KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË

Për: Zyrën e Rregullatorit për Energji, Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë

DUKE PASUR PARASYSH SE [emri i të licencuarit furnizimit] (më tej "licencuarit Furnizimit"), pas pranimit të dosjes së tenderit me titull "Zgjedhja e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit" sipas Numrit të Prokurimit të përmendur më lart., beson se janë të nevojshme informacionet shtesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

*Identifikimi i informacioneve shtesë ose sqaruese, duke përfshirë referencat në seksionin (et) e dosjes së tenderit:*

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar të licencuarin për Furnizim, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identifikuar.

Identifikimi i të Licencuarit për Furnizim	
Emri i Furnizuesit të Licencuar:	
Adresa e plotë:	
Adresa e plotë:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	





## Aneksi 5. KRITERI PËR DHËNIE

*[Elementet e mëposhtme për të përcaktuar kritere janë jo të plota dhe jo të detyrueshme. Ata do të përzgjidhen në përputhje me nevojat e ZRRE-së dhe në varësi të dhënies së shërbimeve për furnizim të garantuar]*

	Kategoritë	Përshkrimi i kriterit për dhënie	Pesha
1	<b>Oferta Financiare (Kosto Direkte Totale e Furnizimit me Pakicë)</b>	Tenderuesi me ofertën financiare më të ulët do të renditet më së larti.	<b>100 %</b>



## Aneksi 6. MODEL I GARANCIONIT PËR PERFORMANCË

*[Me logon e institucionit financiar që e jep garancinë]*

**Për: Zyrën e Rregullatorit për Energji, Rr. Dervish Rozhaja nr. 12, 10000 Prishtinë, Kosovë**  
(Tutje "ZRRE").

**Në emër të: [emri dhe adresa e të licencuarit për furnizim]**

(Tutje "i licencuari për furnizim")

**Titulli i aktivitetit tenderues: ZGJEDHJA E FURNIZUESIT TË MUNDËSISË SË FUNDIT**

### Garancioni me kërkesën e parë

DUKE PASUR PARASYSH se i licencuari për furnizim ka marrë përsipër të depozitohet një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me tenderin e lartpërmendur për zgjedhjen e furnizuesit të mundësisë së fundit të dërguar nga ZRRE;

DHE DUKE PASUR PARASYSH se i licencuari për furnizim dëshiron të depozitohet një garanci për shumën e specifikuar në dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim të Licencuarit për Furnizim një garanci të tillë:

PRANDAJ NE nëpërmjet kësaj konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të të Licencuarit për Furnizim, deri në një total prej [.....] € dhe ne zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim ku deklaroni se i Licencuari për Furnizim ka dështuar për shkak se:

- ZRRE mbi bazën e provave të verifikuara objektivisht konstaton se i licencuari për furnizim nuk i ka përfunduar detyrimet e saj të Furnizuesit të Garantuar dhe kjo ka shkaktuar humbje të konsiderueshme për ZRRE dhe / ose shpenzime të mëdha për përfundimin e këtyre shërbimeve; dhe
- I Licencuari për Furnizim ka dështuar të kryejë obligimet e Furnizimit të Garantuar, që lë shumë punonjës pa paguar apo edhe furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e lartpërmendur do të bëhet pa kundërshtim apo ankesë, sa më shpejt që të jetë e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin e "pranimit".

**Ky garancion është valid për 37 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

\_\_\_\_\_  
Emri i institucionit financiar

\_\_\_\_\_  
Adresa

\_\_\_\_\_  
Data



## Seksioni I. Formulari i TENDERIT

Për: [shkruaj emrin dhe adresën e ZRRE]

(tutje "ZRRE")

Titulli: [shkruaj Titullin]

Në përgjigje të letrës suaj të ftesës dhe Vendimit për hapjen e procedurës së tenderimit për zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit për ofertë për shërbimet e kërkuara, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjen e dosjes së tenderit [shkruaj emrin e tenderit]. Ne kësisoj pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne e kuptojmë se të gjitha dispozitat përkatëse në lidhje me shërbimin e FMF do të aplikohen dhe ne pajtohemi të pranojmë nga ZRRE Licencën për Furnizim të plotësuar, nëse zgjedhemi si Furnizues i Mundësisë së Fundit.
3. Ne ofrojmë për të kryer, në përputhje me kushtet e dosjes së tenderit dhe kushtet dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

[shkruaj përshkrimin e shërbimeve]

4. Oferta Financiare (Kosto Direkte Totale e Furnizimit me Pakicë) është:

**Oferta Financiare në numra:** [shkruaj Ofertën Financiare në numra €]

**Dhe në fjalë** [shkruaj Ofertën Financiare në fjalë Euro]

5. Ky tender është valid për një periudhë prej [....] nga data finale për dorëzim të tenderëve.
6. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të ofrojmë, sipas kërkesës, një siguri të ekzekutimit para pranimit të zgjedhjes si Furnizues i Mundësisë së Fundit prej [shëno shumën e garancisë].
7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno emrin], në të drejtën tonë të udhëhequr nga vetja. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për shërbime të njëjta në çfarëdo forme tjetër.
8. Ne do të njoftojmë ZRRE-në menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të shërbimeve. Ne gjithashtu e dimë dhe pranojmë se çdo informatë e pasaktë ose jo e plotë që jepet me qëllim në këtë aplikacion mund të rezultojë në përjashtimin tonë nga këto shërbime.
9. Ne e kuptojmë se ZRRE nuk është e obliguar të procedojë me këtë tenderim dhe e rezervon të drejtën e dhënies së shërbimeve të definuara këtu dhe se nuk do të krijojë obligime ndaj nesh nëse e bën një gjë të tillë.
10. Ne theksojmë se ZRRE, bazuar në diskrecion të arsyeshëm, mund të anulojë procesin tenderues ose të ndërpresë dhënien dhe zgjedhjen e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit.

11. Informatat e detajuara të ofruara:

<b>Oferta Financiare (Kosto Direkte Totale e Furnizimit me Pakicë)</b>	<b>EUR</b>
--	------------



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**REGULATORNI URED ZA ENERGIJU**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**



**DORËZUAR NGA**

IDENTIFIKIMI I TË LICENCUARIT PËR FURNIZIM	
EMRI I KOMPANISË	
ADRESA E PLOTË	
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI& MBIEMRI	
POZITA	
NËNSHKRIMI	
DATA	
VULA	

**Emri dhe mbiemri emri i personit të autorizuar në mënyrën e duhur për të nënshkruar tenderin në emër të të Licencuarit për Furnizim: [shkruaj emrin dhe mbiemrin]**

**Nënshkrimi:[nënshkrimi i personit të autorizuar]**

**Vendi dhe data: [shkruaj vendin dhe datën]Vula e Liderit: \_\_\_\_\_**



## Seksioni II. OFERTA FINANCIARE

<b>Oferta Financiare (Kosto Direkte Totale e Furnizimit me Pakicë)</b>	<b>EUR</b>
--	------------

IDENTIFIKIM I TË LICENCUARIT PËR FURNIZIM	
EMRI I FURNIZUESIT TË LICENCUAR	
EMRI DHE EMRI I PARË I PËRFAQËSUESIT	
NËNSHKRIMI:	
DATA:	
VULA:	